



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**

**Nr.642, datë 23.12.2020**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR PASJE/NJOHJE TË STATUSIT TË  
KËSHILLTARIT/NDIHMËSIT LIGJOR JOMAGJISTRAT  
PRANË GJYKATËS SË LARTË TË Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 97, 98, 100, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 151 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 36/3, të Kodit të Procedurës Civile, në nenin 66, të Kodit të Procedurës Administrative, në propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

**VENDOSI:**

1. Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga z. {...}, për deklarimin e pasjes/njohjes së statusit të këshilltarit/ndihmësit ligjor jomagjistrat pranë Gjykatës së Lartë, për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, bashkë me vendimin përfundimtar.
3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**